



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 18 nëntor 2013  
Nr.ref.:RK498/13

## **AKTVENDIM PËR PAPARANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI126/13**

Parashtrues

**Shaqir Vula**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë  
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 293/2012,  
të 17 majit 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Shaqir Vula, jurist i diplomuar, me vendbanim në Gjakovë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i konteston vendimet gjyqësore në vijim: Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, Rev. 293/2012, të 17 majit 2013; Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. Nr. 132/2012, të 12 qershorit 2012 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, C. Nr. 292/2008, të 20 shtatorit 2011.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë ka të bëjë me shkeljen e pretenduar të të drejtave kushtetuese të parashtruesit, përkritazi me të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës; neni 6.1 i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe e drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit (neni 49 i Kushtetutës).
4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 293/2012, të 17 majit 2013.

## **Baza juridike**

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 i 16 dhjetorit 2008, i hyr në fuqi më 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 19 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë në Gjykatë.
7. Më 30 gusht 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI 126/13, e caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi si Gjyqtare raportuese. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI 126/13, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Kadri Kryeziu (anëtar)
8. Më 12 shtator 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me regjistrimin e kërkesës.
9. Më 21 tetor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

10. Kjo kërkesë është parashtruar në Gjykatë për shkak të ndërprerjes së kontratës së punës së parashtruesit në pozitën e avokatit publik komunal.
11. Sipas pasqyrës së fakteve të parashtruesit, parashtruesi ishte emëruar avokat publik komunal sipas vendimit të Kuvendit Komunal për periudhën kohore prej

vitit 2003 deri më 2006. Gjatë kësaj periudhe, parashtruesi e ka pasur kontratën e punës për periudhën kohore të lartcekur.

12. Pas skadimit të kontratës së parë të punës, për periudhën prej vitit 2003 gjer më 2006, parashtruesi vazhdoi të punojë si avokat publik komunal, sipas vendimit të Kuvendit Komunal të Gjakovës, 01 nr. 112-21266/2007, të 1 qershorit 2007, i cili përcaktonte:

*“Parashtruesit i vazhdohet kontrata e punës në postin e avokatit publik komunal në kohëzgjatje deri në përfundimin e procedurës së konkursit për këtë post.”*

13. Për qëllim të vazhdimësisë së postit, kontrata e punës i është vazhduar parashtruesit deri në përfundimin e periudhës së rekrutimit në postin në të cilin parashtruesi i kërkesës ishte momentalisht.
14. Punësimi iu vazhdua parashtruesit pastaj me anën e tri kontratave të njëpasnjëshme për periudha tre (3) mujore.
15. Më 31 mars 2008, ishte ndërprerë vazhdimi i kontratës së punës.
16. Më pas, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë, Aktgjykimi C. Nr. 56/2010, i 7 prillit 2011, me të cilin u refuzua padia e tij si e pabazuar.
17. Pas kësaj, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi Ac. Nr. 132/2012, i 12 qershorit 2012, me të cilin refuzohet përfundimisht ankesa e parashtruesit të kërkesës.
18. Parashtruesi i kërkesës, kundër vendimit të gjykatës së instancës së dytë, parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme. Ai nga Gjykata Supreme kërkoi shqyrtimin e vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe të vendimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë.
19. Më 17 maji 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. 293/2012), refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion. Në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme përmend se: “padiësi ishte emëruar avokat publik komunal sipas vendimit të Kuvendit Komunal në periudhën prej vitit 2003 deri më vitin 2006. Kontrata e punës i është vazhduar me kontratën ZK-01/17 të 7 janarit 2008, deri në ndërprerjen përfundimtare të kontratës, më 31 mars 2008. Parashtruesi (padiësi) është njoftuar më 13 mars 2008 nga Komuna e Gjakovës se kontrata e tij e punës do të skadojë më 31 mars 2008 dhe se ajo nuk do të vazhdohet. Sipas dokumenteve të gjykatës, parashtruesi kishte hyrë në marrëdhënie pune me vullnetin e tij dhe ai e kishte kuptuar se periudhat kohore të kontratave ishin për një kohë të caktuar.
20. Gjykata Supreme për më tepër kishte konstatuar që:

*“Edhe pse në revizion pretendohet se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, ato nuk janë precizuar, por vetëm është parafrazuar përmbajtja e nenit 182 të LPK-së, se revizioni nuk*

*ka arsytim për këtë bazë ligjore, ndërsa kjo gjykatë, në bazë të nenit 215 të LPK-së, përveç zotësisë për të qenë palë dhe për përfaqësimin e rregullt të palëve në procedurë, sipas detyrës zyrtare, nuk shqyrton ekzistimin e shkeljeve të tjera esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Për këtë arsye u gjet se ky pretendim i revizionit nuk është i bazuar.”*

21. Përkitazi me *“aplikimin e gabuar të së drejtës materiale në revizion”*, ajo gjeti se *“paditësi nuk ka pasur vërejtje në kontratën e fundit të punës të 7 janarit 2008, për periudhën prej 1 janarit 2008 deri më 31 mars 2008 dhe e ka nënshkruar me vullnetin e vet, që bie ndesh me pretendimin e cekur dhe e bën të pabazuar.”* Prandaj, Gjykata Supreme konstatoi se thëniet në revizion nuk mund të aprovohen dhe në rastin konkret të parashtruesit, me pretendimet e revizionit nuk vihet në dyshim bazueshmëria ose ligjshmëria e aktgjykimeve të gjykatave të shkallëve më të ulëta. Në bazë të kësaj, Gjykata Supreme, në pajtim me nenin 222 të LPK-së, vendosi që revizioni i parashtruesit të kërkesës të refuzohet si i pabazuar.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjatë rrjedhës së procedurave të lartpërmendura, të drejtat e tij kushtetuese janë shkelur për shkak se gjykatat përkatëse nuk i kishin zbatuar dispozitat e aplikueshme të ligjit.
23. Sipas kërkesës së parashtruesit dhe pasqyrës së fakteve, parashtruesi pretendon se *“gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit dhe ajo e revizionit kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale.”*
24. Sipas parashtruesit, gjatë të gjitha fazave të procedurës, gjykatat përkatëse nuk arritën të *“ofrojnë arsytim të nevojshëm ligjor, të bazuar në ligj.”*
25. Ai gjithashtu pretendon se, vendimi për të mos vazhduar kontratën e tij të punës *“drejtpërsëdrejti i shkel dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP/DASHC 2003/02 PROCEDURAT E KONTRATAVE për zbatimin e Urdhërësës Administrative 2003/2 - Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në pikën 4, kur bëhet fjalë për përtëritjen e kontratës, parasheh: “Kontrata e punëtorit normalisht duhet të zgjatet për periudhën trevjeçare kur përtëritja e saj vjen si shkak i përfundimit të kontratës së parë me kusht që: “4a.1 buxheti për postin është në dispozicion ose është sipas të gjitha gjasave i mundshëm të jetë i tillë, 4a.2 aty ku nuk ka masa disiplinore kundër punonjësit për shkelje serioze.”*
26. Parashtruesi për më tepër pretendon se:
- a) *“punësimi i tij nuk do të duhej të ndërpritej derisa të kryhej vlerësimi i tij i punës, në mënyrë që t’i lehtësohej punëdhënësit që të vendosë nëse do ta zgjasë kontratën e punës ose ta plotësojë postin përmes shpalljes publike.*
- b) *se gjatë punësimit të tij si avokat publik komunal, ai kishte dorëzuar raporte vjetore, që ishin vlerësuar si të suksesshme, pa asnjë vërejtje në rezultatet e punës, dhe*

*c) se kontrata e tij nuk është dashur të ndërpritej, sepse ai e kishte kryer punën në mënyrë të kënaqshme”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

27. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata, para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
28. Gjykata së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesën në Gjykatë. Parashtruesi në rastin konkret është person fizik, prandaj Gjykata vlerëson se parashtruesi e ka përmbushur kriterin e kërkuar me nenin 113 (7) të Kushtetutës që përcakton se: *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë [...]”.*
29. Gjykata po ashtu vëren se, parashtruesi i ka përmbushur kërkesat e përcaktuara me nenin 113 (7) të Kushtetutës dhe nenin 47 (2) të Ligjit si dhe rregullin 36.1 (a) të Rregullores, përkitazi me shterimin e mjeteve juridike të parapara me ligjet në fuqi.
30. Gjykata vëren më tej, nëse parashtruesi e ka parashtruar kërkesën brenda afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores, për ta paraqitur kërkesën brenda periudhës katër (4) mujore. Parashtruesi vendimin e fundit (Rev. 293/2012, 17 majit 2013) e ka pranuar, më 2 korrik 2013 dhe kërkesën në Gjykatë e ka dorëzuar më 19 gusht 2013, që nënkupton se kërkesa është parashtruar në pajtim me dispozitat e lartcekura.
31. Për qëllime të pranueshmërisë, Gjykata, gjithashtu duhet të marrë parasysh nëse kërkesa e parashtruesit i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në rregullin 36.1 (c) dhe dispozitat e rregullit 36.2 të Rregullores së punës, që parashohin si në vijim:

*36 (1) “Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

*[...]*

*c) Kërkesa është qartazi e bazuar.*

*36 (2) “Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;*

*b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*

*c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose*

*d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

32. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës ankohet kryesisht ndaj vendimeve të gjykatave të rregullta për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material, për mungesën e arsytimit të atyre vendimeve dhe për shkaqe të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e tij në punë.
33. Gjykata duhet t'ia përkujtojë parashtruesit se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt që të vlerësojë ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimeve të dhëna nga gjykatat e rregullta, përveç nëse ka prova bindëse se vendimet e tilla janë dhënë në një mënyrë dukshëm të padrejtë dhe të paqartë. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I.)
34. Në kërkesën e parashtruesit, nuk ka asnjë provë që tregon se ndonjë prej të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë janë shkelur. Gjatë rrjedhës së procedurës së rregullt, parashtruesit i është ofruar mundësia për të paraqitur rastin e tij, me fakte dhe prova, tek ato gjykata përkitazi me pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave të pretenduara. Nuk është detyrë e Gjykatës të shqyrtojë vendimet e gjykatave të rregullta thjesht sepse parashtruesi nuk ishte i kënaqur me rezultatin e vendimeve të mëparshme.
35. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit konsiderohet qartazi e pabazuar dhe si e tillë e papranueshme.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, me 21 tetor 2013, njëzëri

### VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani